



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes Medina Brahaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes	
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkëlqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 28/03/2018
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Shtimes	Nr. 020/361
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Npi-01/43 për zgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi, mirëqenie sociale, ambient dhe shërbime publike.
I miratuar më datë: 09.03.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 14.03.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi Npi-01/43 për zgjedhjen e Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale ambient dhe shërbime publike.	<p>Vendimi Npi-01/43 për zgjedhjen e Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale ambient dhe shërbime publike, është në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-040, Për Vetëqeverisje Lokale përkatësisht Nenin 47 pika 47.3 ku sqarohet se kërkesa për shtimin ose heqjen e një pike të rendit të ditës mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.</p> <p>Vendimi Npi-01/43 për zgjedhjen e Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale ambient dhe shërbime publike, nuk ka qenë e paraparë për shqyrtim në këtë mbledhje.</p> <p>Andaj miratimi i këtij vendimi nga kuvendi i komunës pa qenë në rend dite është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë nuk krijon efekt juridik.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Naim Ismaili, gradonačelnik Opštine Štimlje Medina Brahaj, predsedavajuća Skupštine opštine Štimlje	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenanta u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Odeljenja za zakonska mpitanja i monitorisanje opština/ MALS	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>BF. Todosijević</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Shkëlqim Jakupi, <i>Shkëlqim Jakupi</i> rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanja opština, MALS	Datum: 28.03.2018.
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti akta opštine Štimlje	020-361
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelniče,
Poštovana predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka Npi-01/43 za izbor Odbora za zdravstvo, blagostanje, sredinu i javne usluge.
Usvojena dana, 09.03.2018. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 14.03.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisanje u aktu opštine	Zakonske odredbe sa kojima je akt opštine u suprotnosti.
1.	Odluka Npi-01/43 za izbor Odbora za zdravstvo, blagostanje, sredinu i javne usluge.	<p>Odluka Npi-01/43 za izbor Odbora za zdravstvo, blagostanje, sredinu i javne usluge je u suprotnosti sa Zakonom br. 03/L-040, o lokalnoj samoupravi, članom 47 tačka 47.3 gde se objašnjava da zahtev za dodavanje ili ukidanje tačke dnevnog reda može biti odobren ili odbijen većinom glasova.</p> <p>Odluka o izboru Odbora za zajednice nije predviđena za razmatranje na ovom sastanku.</p> <p>Stoga usvajanje ove odluke Skupštine opštine bez upisa u dnevni red je u suprotnosti sa važećim zakonima i kao takvo na stvara pravni efekat.</p>

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave, od skupštine opštine i gradonačelnika traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog vremenskog roka od 30 dana od dana primljenja zahteva za razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za dalja objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-6636 datë:01.03.2018



Npi - 01/43 datë: 09.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12 dhe nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Nenin 34.2 të Statutit të Komunës së Shtimes. Kuvendi Komunes së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2018, korrigjoi vendimin e Kuvendit Nr.01/060/01-2091-26 të datës 31.01.2018 dhe aprovoi këtë:

Ministrit të Pushtetit Lokal
Samir Krasniqi
Government Administration
14.03.2018
-01-020-361

V E N D I M

**PËR ZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI, MIRËQENIE SOCIALE,
AMBIENT DHE SHËRBIME PUBLIKE**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2018, e mbajtur më datën: 09.03.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për Korrigjimin e Vendimit të Kuvendit Nr.01/060/01-2091-26 të datës 31.01.2018, dhe zgjodhi Komitetin për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, në këtë përbërje:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi
1	Shefki Dauti	Anëtar i Komitetit nga (PDK)
2	Herolind Selmani	Anëtar i Komitetit nga (PDK)
3	Milot Deliu	Anëtar i Komitetit nga (PDK)
4	Skender Hyseni	Anëtar i Komitetit nga (LDK)
5	Marigona Pajaziti	Anëtare e Komitetit nga (LVV)
6	Isak Muslija	Anëtar i Komitetit nga (AAK)
7	Rexhep Gashi	Anëtar i Komitetit nga (LB)

II

Vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Nr.01/060/01-2091-26 i datës 31.01.2018, për zgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, shfuqizohet.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj